

FONDI I DORËSHKRIMEVE ME ALFABET ARAB NË AQSH

Hyrje

Në Arkivin Qendror të Shtetit, përveç pasurive dokumentare kryesisht në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të ndryshme të perëndimit, ruhen edhe burime dokumentare në gjuhët orientale. Ato mund t'i klasifikojmë në burime arkivore dokumentare osmane, në dorëshkrime dhe në shtypshkrime në gjuhët orientale: në arabisht, në turqishten osmane dhe në persisht. Burimet dokumentare kapin shifrën e një milion dokumenteve dhe kanë rëndësi për studimin e historisë së Shqipërisë gjatë sundimit osman, dorëshkrimet kapin shifrën 400 dhe po aq janë edhe shtypshkrime në gjuhët orientale.

Në kumtesë i referohem Fondit 725 dhe jo dorëshkrimeve orientale, sepse në Arkivin e Shtetit ruhen nëpër dosje të ndryshme edhe dorëshkrime të tjera të këtij lloji, të cilët, gjatë përpunimit të materialit, për arsye të ndryshme, janë përfshirë në fonde të tjera nga arkivistët e mëparshëm përgjegjës për klasifikimin e materialit arkivor. Fondi 725 u krijua në arkiv në vitin 2000, pas punës së organizuar atëherë nga një grup i përbërë nga arkivistë shqiptarë dhe profesorë të universitetit Gazi në Ankara.

Rezultatet e kësaj pune kërkimore dhe klasifikuese u konkretizuan me inventarin që mori numrin 725, një botim artikulli në revistën "Haxhi Bektash Veli" dhe një botim libër në gjuhët shqipe, turke dhe angleze të titulluar "Katalogu i dorëshkrimeve osmane në arkivat e Shqipërisë".

Në të vërtetë, përmbajtja e librave ka qenë e studiuar edhe më parë nga arkivistët e vjetër që njihnin gjuhët orientale, si Haki Sharofi dhe Jonuz Tafilaj, të cilët u bashkëngjishnin librave nga një pusullë letre ku shënonin të dhënat e tyre. Po të kemi parasysh fatin që patën dorëshkrimet orientale, madje edhe

burimet historike në këto gjuhë, në vende të tjera të Ballkanit gjatë periudhës komuniste në këto vende, të cilat u asgjësuan pa më të voglën keqardhje, duhet të çmohet roli sado i padallueshëm në dukje i këtyre intelektualëve si dhe të tjerëve si ata, të cilët arritën të sigurojnë që dorëshkrimet të mos asgjësohen, por të mbërrijnë deri në ditët tona.

Praktika e mëparshme ka qenë që, pasi arkivisti jepte të dhënat, ato të shkruheshin nga një tjetër arkivist apo punonjës që përgatiste inventarin. Duke qenë se sqarimet ishin të gjata dhe nuk mund të shkruhej gjithçka prej tyre, punonjësi që përgatiste inventarin, në varësi të njohurive që kishte, përzgjidhte pjesët që i dukeshin më të rëndësishme. Kjo praktikë bënte që ndonjëherë të shkëputeshin sqarime që nuk e përfaqësonin burimin arkivor - dorëshkrimin në tërësinë e tij. Kështu, dorëshkrimi i ruajtur në D. 241 shënohet si regjistër i tregtisë dhe tarikateve në Berat, por nuk ka të bëjë aspak me këtë sqarim. Ndonëse në këtë dorëshkrim përmendet në dy-tri vende Berati, pjesa dërrmuese e tij ka të bëjë me letërkëmbimin e pashallarëve të Shqipërisë së Veriut dhe të Mesme për probleme të ndryshme politike, ekonomike dhe shoqërore.

Prandaj unë do të thoja që të dhënat në katalog duhen pranuar me rezervë. Gjatë përpunimit të informacionit, në këtë kumtesë unë jam përpjekur që, me anë të dipnotave, të shënoj ndryshimet në lidhje me këto të dhëna.

Gjithashtu, në katalogun e botuar janë përfshirë edhe shtypshkrime, botime litografike, letërkëmbime dhe shkresa zyrtare, kopjime në fletore të dorëshkrimeve. Këto të fundit më shumë se dorëshkrime mund të trajtohen si veprimtari hulumtuese me qëllim studimesh krijuese.

Zhvillimi i kulturës orientale në Shqipëri në vija të shkurtra

Brenda administratës osmane shqiptarët njohën një ndër mundësitë më të mira për të përjetuar një prosperitet ekonomik që do t'i mundësonte edhe bazën e duhur materiale për të mbështetur zhvillimet kulturore si në kulturën e shkruar të librave, ashtu edhe në atë të arkitekturës së kultit.

Kultura orientale në trevat shqiptare qe rezultat i procesit të islamizimit masiv të shqiptarëve gjatë sundimit osman.

Ruajtja e një numri të madh dorëshkrimesh, pjesa më e madhe e tyre me vlera kaligrafike dhe përmbajtje të pasur, është trajtuar si një çudi që ngjante në periferi të Perandorisë Osmane. Një qasje e tillë vihet re edhe te studimet e kryera në lidhje me arkitekturën e kultit islam në këto treva. Kjo buron nga mënyra e konceptimit dhe vendi që u është dhënë në skenën e zhvillimeve perandorake trevave shqiptare duke u nisur më shumë nga realitet e krijuara pas Luftës së Parë Botërore dhe mungesës së dokumentacionit në gjuhën osmane të vënë në dispozicion të studiuesve.

Trevat shqiptare dhe shqiptarët kanë qenë shumë pranë qendrës së Perandorisë Osmane dhe lëvizja e fuqive njerëzore drejt kryeqendrës së perandorisë ka qenë e vazhdueshme, aq sa në shekullin XVIII, si në shumë akte perandorake, ashtu edhe në rregulloret e rendit publik për Stambollin do të gjejmë urdhëresa për parandalimin me çdo kusht të fluksit të imigrimeve të mëdha shqiptare ndaj qendrës perandorake.

Një rol të rëndësishëm në plazmimin e kulturës orientale në trevat shqiptare gjatë shekujve klasikë osmanë luajti klasa e jeniçerëve me origjinë shqiptare, më të njohurit e të cilëve qenë ata që arritën majat e administratës osmane duke u bërë sadrazamë.

Sadrazamët me origjinë shqiptare, si pjesëtarët e dinastisë Qyprii, arkitektët e njohur të Perandorisë, si Sinani, Sedefqar Mehmedi (arkitekti i xhamisë së sulltan Ahmetit ose siç njihet në perëndim si Xhamia Blu) dhe Kasemi, që e stolisën kryeqytetin e perandorisë dhe rajonet e tjera të tij me kryevepra arkitekturore, nuk i patën këputur asnjëherë lidhjet me fshatrat shqiptare nga të cilat e kishin origjinën, duke financuar kryerjen e veprimtarive ndërtimore të kultit. Vlen të përmendim faktin që biblioteka e ndërtuar nga *Qypriiu* në Stamboll konsiderohet si objekti i parë me shërbimin si bibliotekë e pavarur në historinë e bibliotekave të perandorisë, në dallim nga bibliotekat e deriatëhershme që konsideroheshin vetëm pjesë plotësues e objekteve të tjera, si: xhamitë, teqetë, familjet e pashallarëve etj.

Në mënyrë të veçantë, ata jeniçerë shqiptarë që shkuan një jetë si ushtarë të thjeshtë, luajtën rol në vendosjen e kulturës orientale kur vendoseshin në fund të jetës së tyre nëpër fshatrat e

vendlindjes dhe ndërmerrnin me paratë e mbledhura ndërtimin e objekteve të kultit.

Shqiptarët në administratën ushtarake, civile dhe atë klerike qenë në numër shumë të madh duke shërbyer jo vetëm në trevat shqiptare dhe ato të Ballkanit, por edhe në sanxhaqet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore, si: në Persi, në Egjipt, në Algjeri, në Liban, në Hixhaz etj.

Kjo tablo e krijuar me fakte historike të njohura në mënyrë masive na jep mundësinë të hamendësojmë që edhe pasuritë e dorëshkrimeve, të cilat shfaqen si pjesë integrale e kulturës osmane në të gjitha qendrat urbane të perandorisë, të kenë qenë të kultivuara dhe të përhapura në hapësirat shqiptare.

Por nuk duhet lënë pa përmendur edhe ndikimi i elementit joshqiptar në konsolidimin e kulturës orientale në trevat shqiptare, pashallarë nga trevat e Anadollit apo Ballkanit që kaluan një pjesë të jetës së tyre nëpër sanxhaqet shqiptare.

Shënimet që ndodhen në fletët e brendshme të kapakëve të parmë dhe të fundit të dorëshkrimeve, por edhe anëshkrimet, na mësojnë rreth pronarëve të ndryshëm nëpër të cilat kanë kaluar ato dorëshkrime.

Të dhëna për raste kopjesh të shkruara me një stil të zhdërvjellët kaligrafik janë dokumentuar nga Ali Emiri, themeluesi i bibliotekës së famshme në Stamboll që për një kohë të gjatë u mbajt si biblioteka kombëtare, i cili vizitoi si Janinën, ashtu edhe Shkodrën në cilësinë e inspektorit.

Pohimi i tij ka rëndësi, sepse Ali Emiri nuk qe një lexues i rregullt, por një bibliofil i vërtetë i librave dhe i bibliotekave dhe i njëjhte shumë mirë bibliotekat e perandorisë që nga Diyarbakëri deri në Stamboll, kështu që habia që ai përjetoi kur u takua me dorëshkrimet orientale në Shkodër e shtyu që poezinë orientale në këto treva ta cilësonte “një thesar i zbuluar në Perandorinë Osmane”.

Mes të tjerash, ai flet për kopje të rralla të divaneve të cilat nuk i kishte parë ndokund tjetër. Ky pohim i këtij bibliofili të rrallë të kulturës orientale, zbuluesit të fjalorit më të vjetër turk, na lejon që të hamendësojmë për një traditë të zhvilluar të bukurshkrimeve orientale në Shqipëri.

Zhvillimi i kulturës, cilitdo qytetërim që t’i përkasë atij në

mesjetë, do të ishte i pamundur pa mbështetjen ekonomike të njerëzve të fuqishëm të kohës. Prandaj nuk është rastësi që dorëshkrimet orientale më me vlerë si nga cilësia, ashtu edhe nga përmbajtja që ruhen në Arkivin e Shtetit u përkasin shekullit XVIII dhe gjysmës së parë të shekullit XIX, që korrespondojnë me periudhën e lulëzimit të oxhaqeve të pashallarëve me origjinë shqiptare dhe me sundimin e dy pashallëqeve të mëdha, atij të Bushatllive në Veri dhe Ali pashë Tepelenës në Jug.

Për këta dy të fundit është i njohur fakti që, për të zhvilluar jetën kulturore të pashallëqeve të tyre, patën marrëdhënie dhe sollën përkrahë artistëve, arkitektëve dhe poetëve edhe njerëz të përshpirtshëm që ushtruan aktivitetin e tyre fetar në mesin e shqiptarëve. Këta persona me diapazon të gjerë fetar duhet të kenë kultivuar edhe dimensione dhe zhvillime të qytetërimit islam që nuk ishin të përhapura në perandorinë otomane.

Kështu, në Arkivin e Shtetit ruhet vakëfnameja e datës Muharrem 1284 H (1868) e sheh haxhi Ahmet efendiut nga Maroku, i njohur si sheh Magribiu (Marokeni) i cili, mes të tjerash, urdhëron të shkruhet që “librat e shkruar dhe të zbukuruar me dorën e tij do t’i dhuroheshin bibliotekës së medresesë së Kara Mahmut pashë (Bushatlliut), ndërsa librat e shkruar në stilin kaligrafik të Magribit (varsh) do t’i dhuroheshin bibliotekës së xhamisë Zejtuna (në Tunizi)”.

Interesant është fakti që disa prej dorëshkrimeve, madje veprat letrare si divan etj të jenë kopjuar nga banorë të fshatrave të thella të Shqipërisë.

Dorëshkrimet orientale për nga përmbajtja

Dorëshkrimet hedhin dritë mbi historinë e kulturës së shkruar në trevat shqiptare në gjuhët orientale, nëpërmjet të dhënave që na japin me anë të origjinës së tyre, autorëve dhe dorëshkruesve të tyre. Humbja apo shqyerja e kapakëve apo fletëve të para dhe të fundit të dorëshkrimeve na privojnë nga grumbullimi i të dhënave që hedhin dritë mbi rrugëtimin e dorëshkrimeve.

Dorëshkrimet janë libra (kitap), traktate (risale), komentare (sherh), përmbledhje (mexhmua), kompendium (muhtasar), antologji.

Në mesin e dorëshkrimeve kemi edhe rastin kur dorëshkrime të ndryshme janë bashkuar me një kapak, praktikë e përhapur për dorëshkrimet orientale. Kështu, D. 122 përbëhet nga 8 dorëshkrime të kapura me një kapak dhe janë dorëshkrime në gjuhën arabe, kopjuar në vite të ndryshme (1797, 1789, 1806) dhe që flasin mbi tema të ndryshme.

Po t'i klasifikojmë nga përmbajtja dhe lloji, atëherë konstatojmë se në fondin e dorëshkrimeve orientale të F. 725 ruhen Kuran (si libër) 25, Ilmihal 22, Tefsir 10, Mjekësi 4, Mistika 41, Akaid 12, Kelam 3, Nasihat 10, Fikh 15, Hadith 2, Divan 18, Eshar 27, Nefes 4, Mesnevi 2, Mevlud 2, Insha 4, Erkanname 18, Gylbank 1, Xhonk 43, Dua 30, Astrologji 13, Sijer 10, Tarih 12, Fetva 6, Hesap 4, Felsefe 3, Logjik 3, Hukuk 6, dorëshkrime të formuara nga kapja e fletëve të librave të ndryshëm 93.

Pjesa më e madhe e dorëshkrimeve i përkasin literaturës mistike të zhanreve të ndryshme të saj, si: histori rreth jetës dhe bëmave të Aliut, ngjarjes së Qerbelasë, dashurisë për ehli bejtin, katekizmit rreth 12 imamëve, traktate dhe libra rreth mësimave të urdhrave msitikë ku dominon ai bektashi; por kemi edhe një silsilname të Xhelvetive dhe një erkanname të Nakshibendive, receta mjekësore për t'u ruajtur nga syri i lig, nganjëherë me tendencë drejt një lloji falli, poezi bektashiane të tipit nefes, xhonk etj. Nuk mungojnë edhe traktatet mistike me një gjuhë më të përpunuar filozofike që i qasen probleme të ekzistencës dhe jetës tjetër nga këndvështrimi mistik.

Kjo përqindje e madhe e kësaj literature shpjegohet me faktin se kjo dorë dorëshkrimesh që është depozituar pranë Arkivit të Shtetit, duhet të jetë marrë nga institucione mistike bektashiane apo jo.

Ndonëse studimet bashkëkohore kanë vënë në diskutim mësimet dhe ritet e krijuara nëpër shekuj në urdhrat mistikë islamë dhe tarikatat, nga aspekti historik, për trevat dhe kulturën shqiptare teqetë e tarikateve të ndryshme kanë luajtur rolin e bibliotekave të sigurta, në të cilat janë dhuruar dhe ruajtur dorëshkrime, por edhe dokumente të rëndësishme historike. Kështu, fermani në bakër që sulltan Mehmeti II u dha esnafëve të Beratit si siguracion të vazhdimësisë së profesionit dhe biznesit të tyre, u ruajt për një kohë të gjatë në teqenë e sheh Hasanit në Berat, ndërsa studiuesi i mirënjohur i letërsisë bejtexhije, Osman

Myderizi, e pati zbuluar këtë letërsi pikërisht gjatë hulumtimeve të tij nëpër teqetë e Jugut. Prandaj sulmet e çetave greke pas Luftës së Parë Botërore dhe djegia e teqeve gjatë këtyre sulmeve duhet të na ketë kushtuar shumë në aspektin e burimeve tona kombëtare historike, kulturore dhe fetare.

Pjesa tjetër e dorëshkrimeve u përkasin fushave, si: letërsia, historia, filozofia, logjika dhe gjuhësia.

Unë do të përmendja këtu shkurtimisht si dorëshkrime me vlerë që ruhen në Arkivin e Shtetit, mes të tjerash:

Felsefe, Logjikë

Felsefe D. 65 (*autori anonim, kopjuar nga Ibrahim bin Mustafa në vitin 1124 H. Vepra përbëhet nga tri pjesë që titullohen "Lumturia", "Mirësia" dhe "Enigma"*) 110 (**Dy traktate në gjuhën arabe njëra 11 dhe tjetra 20 faqe, kopjuar në vitet 1730 dhe 1726 nga Abdurrahman bin Mehmed, që trajtojnë filozofinë dhe debatin logjik (munazara), 282,**

Mistikë

Zubdetu'l-hakikat fi hadd-i mushkilat, Abdullah bin Muhamed Mijaneci (v. 1131), arab dhe pers, flet rreh 100 temave shkurtimisht, me natyrë të filozofisë mistike se si njeriu mund të kapërcejë pengesat që e largojnë nga adhurimi i Zotit), D. 98 (Logjik, Muhtasaru'l-Meani, Mesud bin Umer Taftazani, pa datë kopjimi, arab),

Logjikë D. 153, 448, 470,

Risale Sherhu's-Saadet (autor Sejfedin bin Nizametin, data 1738, turq, 297 folio) mund të jetë origjinale.

Letërsi

Veprat e letërsisë klasike arabe, turke dhe persiane, si Kasidetu'l-burde e Busirit (D. 248), Gylistan dhe Bostan e Saadi Shirazit (D. 4 (gyzel), 91, 114, 291, 299, 303, 421*), Hadikatu'sh-Shuheda e Fuzulit (D. 184, 236, 278, 320) Lejla vu Mexhnun, (D. 383, turq, kopjues Ismail bin Husejin, 1804),

Zhanret e ndryshme të letërsisë klasike osmane, si: divanet, mevludet, mesnevi,

Nga divanet përmendim Divani i Ali Shir Nevait, D. 79^[1],

^[1] Katalogu e regjistron si Bektashi Nefes

Divani i Turabit (D. 9, dorëshkrim i 1864, 202 folio)^[2], i sheh Galipit (D. 62, dorëshkrim i 1799, 199 folio), i hafëz Shemsetin Muhamed Shirazit (D. 77, D. 95, pa datë, 150 folio, D. 201, dorëshkrim i 1456, 146 folio, **Nefis Nefis** D. 483, 1789, 213 folio) persisht, i Shevketit (D. 97, dorëshkrim i 1778, 359 folio, **karişik nefis**) persisht, i Aliut dhuruar Salih Nijazi Dedes komentuar në persisht (D. 195, pa datë, fol **dhuratë e Rauf Ficos**) D. 198, pa datë, foli 168), anonim (D. 196 dorëshkrim i 1867, 10 folio) persisht **pronari Shuajb bin Latif Tafa nga fshati Okshan shkruar në fshatin Kokor**), i Dervish Hysenit nga Edirneja me pseudonimin poetik Shehidi që vdiq në vitin 1671 (D. 234, dorëshkrimi 1845, Sulejman, 265 folio, D. 398, pa datë, Sulejman, 63 folio) turqisht/persisht, i sheh Rizaudin Mustafa Dylgerit (v. 1746) (D. 362, 1806, 37 folio, përmban 159 gazele, 37 nazim, 7 beyit, 2 tarih) turqisht, i Muhitit (D. 364, pseudonim, 1878, 66turkce/105 folio, 191 gazel, 81 kita ve tuyug dhuruar **teqesë së Konicës nga haxhi Kamil baba nga Ankaraja**), i Arshiut dervish i Muhitit, poet Hurufi (d. 1562) (D. 465, 1777, 118 folio, 303 gazel, 5 terci bend, 1 mesnevi, 54 rubai) turqisht,

Nga Mevludet Mevlud D. 85 (**autor Sulejman Çelebi Bursevi, dorëshkrim i vitit 1835**), 240,

Mesnevi D. 36 (**Poezi të dervish Ahmetit, shkruar në vitin 995 H, në Kaninë të Vlorës, nefis**) 78 (Husn-u-Ashk, vepra e shejh Galipit e shkruar me dyvargësh (mesnevi) që trajton temë të përafërt me veprën Lejla dhe Mexhnun) **pa datë**,

Fikh D. 22 (**mistake, tefsir i disa sureve**), 218^[3], 227 (Haleb-, Kebir, libër bazë i fikhut Hanefi, **derkenar**), 318 (**Kitabu'l-ahkamu'l-xhenaiz me autor Ibrahim bin Jusuf Boluvi, arabisht**)^[4], 332 **Fikhi Nesefi, Lutfullah Nesefi shkruar në vitin 1542**), autor **Fadul Kejdani ose Lutfullah Nesefi**, 341 (**Sherh Feraizu Siraxhije komentari i Sejid Xhurxhanit mbi veprën e Sexhavendit, kopjuar në vitin 1816**), 354, 370, 408 (**shtypshkrim i vol II të Miratu'l-Usul të Molla Hysrev**), 438 no ëorthy, 440 no ëorthy, 444 Gunjetu'l-Mutemelli me autor Ibrahim Halebi dorëshkrim i 1747), Multeka'l-

^[2] Në Katalog thuhet "ka shënimin Divan-i Tirani", në të vërtetë është Divani Turabi, Baba Hyso është postnishini i dergjahut të Konicës së cilës i është dhuruar.

^[3] Komplet gjë tjetër.

^[4] Katalogu e regjistron ndryshe

ebhur me autor Ibrahim Halebi, i datës 1724, D. 455 dhe i vitit 1826 D. 491 (**derkenar**), 489 no ëorthy^[5]

Fetva D. 13 (**i datës 1711(1123H) me autor shejhulislam Jahja Minkarizade**)^[6], 116 Min fetavayi sagir ve munyetu'l-mufti *me autor Ibn Abidin*, 177, 223, 306, 333,

Histori

Histori D. 11 (**Tercüme-yi Tarih-i Taberi, ka shënimin blerë me datë --- për vlerën 2 kurush e gjysëm këtu përpara portës së Qabesë në Meke, ndërsa në faqen 2 ka anëshkrimin se wshtw trashwguar nga naibi i Ulqinit**), 23 (**Makteli Hysejin, kopjuar nga një dervish i tyrbes Kyçyk Abdal baba në lagjen Varosh të Krujës**) 24 (**Feraiz, arabisht, 1057 H**)^[7], 121 (vol i parë i dorëshkrimit Hikaye-yi Ebu Muslim Horasani), 224, 255, 315, 353, 384a, 409, 428, 449,

295(Battalname, autor Nevrekuplu Mustafa Beshe Bojaxhi, data kopjimit 1756),

349 (Hikaye-yi sultan Ahmed, arab-turq, data kopjimit 1708, rrëfen festën e rrethprerjes së fëmijëve të sulltan Ahmedit).

450 (**Ixhazetname, arabisht, e datës 1896**),

451b (Risale Ebu'l-Munteha, arab).

Resail Kemal pasazade Ahmed bin Sulejman yada Ibn Kemal (D. 28, v. 1534), pa datë, pa kopjues, përmban 13 traktatet e Ibn Kemalit, turqisht.

Në këtë fond ruhen edhe dy dorëshkrime të letërsisë së bejtexhinjve, një poezi në vargje kushtuar profetit Muhamed (mevlid) në dialektin geg (D. 273) dhe historia e Jusufit shkruar në Korçë nga Rushen efendiu në fundin e shekullit XIX.

Dorëshkrime orientale ruhen në institucione të ndryshme shtetërore dhe private, pa harruar edhe shumë dorëshkrime që ruhen në ambiente familjare, apo nga koleksionues antikash.

Kuranin Fisnik si libër **D. 1 (pa datë), 5 (pa datë), 49 (elifba, litografi)**, 96 (pa datë), 109 (mbart vlera antike, me fletë ari), 127 (pa datë), 133 (me gjithë zbukurimin e rrallë, është dëmtuar nga kushtet atmosferike), 136 (nefis tezhipli), 137 (pa datë), 174 (1824,

^[5] Vasijetu Muhamed bin Pir Ali ketebeha bi Turkiye, Katalogu shkruan Beyan-ı Sıfat-ı Sülbiye

^[6] Ka titullin Sherhu Sheria

^[7] Në katalog është Kitab-ı Nesebiye.

tezhipli), 175 (pa datë) tezhipli, 180 (pa datë, pjesë Kurani), 197 (1861, sejid Muhamed Nuri, anëve ka gylbank me informacione), 202(1861), 205 (antika degeri yuksek), 228 (altin suslemeli, 1884, haxhi Mehmed Nuri Konica), 247 (pa datë, litografi), 250 (pa datë), 305 (pa datë) 311 (pa datë) pjesë nga Kurani, 360 (pa datë, degerli antika), 381 (pa datë), 386 (pa datë), 424 (mund të jetë e shek XV?, përmban përkthimin turqisht mes rreshtave të originalit në arabisht), 426 (dorëshkrim i vitit 1484 (që përmban përkthime turqisht e persisht, 64 folio),

Njohuri të fesë (ilmihal) D. 3 (**nefis**), 12 (**ok**), 42 (**ok**), **76** (viti 1800), **80**, 204, 212, 214, 233, 253, 262, 269, 277, 307, 308, 372, 401, 415, 437, 445, 446, 466,

Tefsir D. 35 (**Tefsiri i Aladağlı, güzel**), 45 (karısık), 58, 139, 176, 194, 200, 203, 310, 387,

Mjekësi D. 2^[8] (Feraiz), 210, 337, 378.

Mistikë D. 6^[9], **7(ok)**, 14 (**Durr-i Meknun me autor Ahmed Bican Gelibolulu, kopjuar në vitin 1783**), 16 (**Velayetname e Haxhi Bektashit, dorëshkrim i 1880**), 26 (**no ëorthy**), 27 (Faziletname-yi Ali, anonim, nga arabishtja në turqisht), 82 (**Traktati Lubu'l-Hakaik i Virani baba kopjuar nga sejid Nazif në vitin 1843**), **83**, 88 (**velayetname**), 132, 143, 161, 185, 186, 187, 215, 216*, 217, 219*, 222*, 243*, 263*, 281, 285, 290, 293, 297, 313 (**Silsilname-yi tarikat-i Xhelvetije me autor Ismail Haki, i vitit 1746**), 319, 321, 330, 361, 393, 406, 410, 411, 463, 469, 473, 484,

Akaid D. 8 (Akaid-i Şerif, autori anonim, kopjuar nga Sulejman bin Aziz Reshad në vitin 1688 (1110) 34 (dhuratë e hafëz Mustafa Rifat nga Pirlepe, banor në Elbasan), 43 (ok), **73**, 403, 412, 434, 453, 454, 456, 460, 481,

Kelam D. 149, 314, 451a,

Letërsi

Poezi D. 93 (**dervish abidin, 1212 (1797) gyzel**), 102, 103, 115, 117, 119, 126, 134, 146, 221, 229, 301, 309, 312, 339, 342, 348, 400, 414, 418, 422, 442*, 464, 485, 486, 490, 494,

Xhonk D. 31, 33 (Bektaşi gazelleri (Gazaliat)^[10], 44, 55 (**ok**), **71**,

[8] Katalogu shkruan Risale-y, Tıp, por është Feraiz.

[9] Katalog shënon Kuvetu'l-kulub është Kutu'l-kulub me autor Ebu Talib Meki dhe jo Ebu Kasim Semerkandi si është në Katalog.

[10] Në Katalog është Geneliyat

81, 84 **no ëorthy**, 89, 94, 99, 111, 118, 123, 125, 128, 129, 144, 145, 148, 158, 208, 209, 213, 231, 235, 245, 259, 260, 270, 298, 322, 325, 328, 331, 343, 359, 365, 368, 377, 431, 433, 462, 479,

Nefes (Bektashi) 92, 495 (**nefis**)

Insha D. 47 (**ok, güzel**), 138, 254, 268,

Erkanname Bektashi, D. 17**ok**, 53 **ok**, 64, 68, 70 (**no ëorth**), 112, 151, 156, 157, 183, 190, 211, 238, 264, 267, 292, 404, 416, 476,

Erkanname Nakshibendije, D. 188, data 1771, turq,
Gylbank, D. 265,

Literaturë bektashiane

Vaka-yi Halaxh Mansur (D. 41, autor Mehmed Sherif bin Ali, data 1890, kopjuesi s'dihet, turqisht)

Hukuk D. 162, 166, 274, 300, 326, 405,

Hesap-Matematikë D. 18 (**no ëorthy**), 182, 280, 302,

Nasihet D. 21(**ok**), 29 (ok), 51 (përkthim në turqisht i librit Ejuhe'l-veled të Gazaliut), 107, 168, 170, 181, 191, 324, 379*,

Dua D. 32 (**pronar Shaban ef Myrteza Ismail'zade nga Kruja, data 1288**), 37 (**ok**), 39 (**ok**), 52 (**ok**), 60 (**ok**), 63, 100, 120, 124, 140, 142, 178, 206, 230, 249, 261, 276, 304, 385, 394, 396, 402, 435*, 436, 457*, 459, 461, 474, 478, 492*,

Astrologji D. 40 (**data 1255 H, magji**), 67 **no ëorthy**, 90 (**gyzel**), 131, 169, 257, 323, 346, 384b, 417, 419*, 420*, 429,

Sijer D. 54 (Delail-i Nübüvet-i Muhamedi ve Şemail-i Fütüvet-i Ahmed-i me autor Mustafa bin Xhelal Tefki, e datës 1091 H)^[1], 72 **no ëorth**, 135, 164, 189, 225, 232, 272, 273, 288,

Hadith D. 316, 407,

Pedagogji D. 108, 179,

Ahlak D. 237

Sixhil D. 241,

Toplam 484 dorëshkrime

Prejardhja e dorëshkrimeve

Një pjesë e mirë e tyre kanë qenë të dhuruara dergjahut të **Konicës** (D. 9, 33, 40, 44, 79, 84, 91, 284, 317, 358, 362, 364), në mesin e të cilave është edhe vepra Genxhine-yi Raz me autor Jahja beun (v. 1582) trashëgimtar i familjes së Dukagjinëve, i krahut të

^[1] Në katalog është 1214.

familjes që në dallim nga Lekë Dukagjini, zgjodhën të jenë vasalë të sulltanit. Jahja Dukagjini është i njohur në letërsinë klasike osmane me elegjinë e tij kushtuar djalit të sulltan Sulejman Ligjvënësit, Mustafasë, që u vra me urdhër të Ligjvënësit pas intrigave të bashkëshortes së tij me origjinë ukrainase Hyrem sulltanit. (D. 284, pa datë, 60 folio)

Ka edhe dorëshkrime dhuruar vakëfit të Sadullahut Vakfit të Sadullahut D. 109 (Kuran, mbart vlera antike, me fletë ari), vakëfit të teqesë Turan në Korçë (D. 50, Sherh Talimu'l-Mutealim me autor Burhanedin Zernuxhi, dorëshkrim i vitit 1837 (1253) dhuratë e Jashar Erebarës), Saatname, Hibetullah Gozcu bin Ibrahim, **turq, ndër librat e rrallë në gjininë e tij flet rreth shkencave ekzoterike, ngjarjeve dhe ndodhive enigmatike, kopjim i 1807, pronari Memush bin Musa ia dhuron mejtepit pranë xhamisë së Fatime bint Mehmed sulltan han.**

Dorëshkrimet që gjenden në F. 725, janë kopjuar nëpër vende të ndryshme, kanë rrugëtuar për të përfunduar së fundmi pranë Arkivit të Shtetit. Gjeografia e kopjuesve është gjithëpërfshirëse për trevat nën sundimin osman. Kështu, në fondin 725 ruhen dorëshkrime të kopjuara në Shkodër, siç është Gramatika arabe (Nahv) e kopjuar në vitin 1842 nga molla Mustafa Borici (D. 382) dhe libri Mecalisu'l-ebrar, autori s' dihet, me kopjues Abdurrahman Nafizi nga Shkodra, viti 1857 (D. 392), dhe në Shqipërinë e Mesme, siç është Risale Hakikat Insanije (D. 46 autori anonim, kopjuesi anonim, shkruar në vitin 1904 (1322) në Elbasan), dhe vepra nga Turqia (D. Vepra Shah-ı Geda (D. 20) pronë e Ferit Vokopolës).